



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.559/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti- anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. PRANOHEN të bazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja VETVËVENDOSJE! me seli në Prishtinë Anr.559/2025 dhe Anr.562/2025 të datës 10.02.2025.

II. Subjektit politik LDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS-LDK, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 2000.00 € (dy mijë Euro).

III. Detyrohet Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 10.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat Anr.559/2025 dhe Anr.562/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje .

-Në ankesën Anr.559/2025 theksohet se më 09 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë gjatë monitorimit të ditës së zgjedhjeve, ka vërejtur postimin nga simpatizanti i LDK-së, Valon Isufi i cili përmes rrjeteve sociale ka avokuar që të votohet subjekti përkatës, gjatë kohës kur është e ndaluar çdo formë e fushatës, konkretisht ditë e zgjedhjeve pas hapjes së vendotimeve në ora 07:00 me datë 09.02.2025. Sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik LDK ka bërë shkelje të nenit 37, paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në

Republikën e Kosovës dhe nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 i Rregullores Zgjedhore NR.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, me çka ka tentuar që në ditën e zgjedhjeve të ndikojë tek votuesit kundërligjshëm.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një CD.

-Në ankesën Anr.562/2025 theksohet më 09 shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje kanë identifikuar se kandidatja nga radhët e Lidhjes Demokratike e Kosovës LDK, znj.Bahrije Hyseni, ka thyer heshtjen zgjedhore me postimin e saj të sponsorizuar në llogarinë e saj në rrjetin social facebook dhe postimi i tillë ka qenë aktiv i sponsorizuar më 09 shkurt, ora 17:59 minuta, ndonëse heshtja zgjedhore kishte filluar me hapjen e qendrave të votimit për votim, përkatësisht në ora 07:00. Sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik LDK ka bërë shkelje të nenit 37, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenin 8 paragrafi 1.5 të Rregullores Zgjedhore NR.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi.

-Në përgjigjen në ankesën Anr.559/2025, subjekti politik LDK ka theksuar se pretendimi se Valon Isufi, sipas ankuesit konsiderohet mbështetës apo simpatizant, në shkrimet e tij në facebook nuk përbënë asnjë shkelje të nenit 37 paragrafi 2, të LZP-së, sepse prova e ofruar nuk është bindëse e as faktike për PZAP, i njëjti nuk është në struktura apo anëtarë i të LDK-së dhe për veprimet e tij personale si qytetar i thjeshtë nuk mund të japim përgjegjësi si subjekt.

-Në përgjigjen në ankesën Anr.562/2025, subjekti politik LDK ka theksuar se pretendimi se Bahrije Hyseni ka shkelur nenin 37 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të LZP-së dhe neni 8 paragrafi 1.5 të Rregullores Zgjedhore 07/2024 të KQZ, nuk qëndron sepse e njëjta me kohë ka ndalur sponsorizimet e tyre në rrjetet sociale facebook, për çka gjeni të bashkangjitura edhe provat.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.559/2025 dhe Anr.562/2025, të datës 10.02.2025 janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.559/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë LVV kundër subjektit të njëjtë politik LDK si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

-Ankesat janë të bazuara

Paneli, pas shikimit shkresave të lëndës të ofruara si prova materiale nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, pas analizimit dhe vlerësimit të përgjigjes në ankesë dhe provave të ofruara si dhe pas hetimeve të bëra, ka gjetur se kandidatja për deputete dhe mbështetësi i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nëpërmjet rrjetit sociale Facebook, ditën e zgjedhjeve me qëllim të bërjes së fushatës zgjedhore dhe me qëllim të promovimit të subjektit politik LDK dhe veten gjatë ditës së votimit kanë bërë thirrje që të votohet subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me numër 124 dhe kandidatët e saj dhe veten, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 37 paragrafi 1 dhe 2 i LZP-së ku përcaktohet se “1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit; bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”.

Paneli, ka shikuar shkresat e lëndës të ofruara si prova materiale nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka analizuar dhe vlerësuar edhe pretendimet e theksuara në përgjigje në ankesë, ku nga kjo përgjigje ky subjekt thekson se “pretendimi se Valon Isufi, në shkrimet e tij në facebook nuk përbënë asnjë shkelje të nenit 37 paragrafi 2, të LZP-së, sepse prova e ofruar nuk është bindëse e as faktike për PZAP, i njëjti nuk është në struktura apo anëtarësi të LDK-së dhe për veprimet e tij personale si qytetar i thjeshtë nuk mund të japim përgjegjësi si subjekt”, për Panelin pretendimet e parashtruara në përgjigje në ankesë janë të pa bazuara për faktin se personi i cekur në ankesë është mbështetës i subjektit politik në fjalë ashtu siç është përcaktuar në Ligjin e Zgjedhjeve në Republikën e Kosovës, andaj paneli i mori për bazë pretendimet ankimore të palës ankuese sa i përket personit të lartcekur, postimi i të cilit është ende është publikuar diën e zgjedhjeve dhe ende është aktiv në rrjetin social facebook.

Andaj Paneli gjeti se veprimet e tilla janë të cekura më lartë në kundërshtim me dispozitat e nenit 37 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike ku përcaktohet se:

1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

1.1. shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit;

1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Andaj, paneli i gjeti ankesat si të bazuara, dhe me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë pasi që personat në fjalë janë njërija kandidatë për deputete dhe tjetri mbështetës i subjektit, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme, gjë që konsiston në faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë ditës së votimit, dhe me rregullat zgjedhore.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.559/2025, datë 13.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.